




QEVERIA NDRYSHON PROJEKTLIGJIN QË DËRGON FSK-në NË OPERACIONE JASHTË VENDIT

FAQE 4+5



Kabineti qeveritar ka miratuar të mërkurën Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë

vendit. Ky projektligj rregullon mënyrën e procedurave të dërgimit dhe tërheqjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit, përcaktimin e

marrjes pjesë në operacionet ndërkombëtare të paqes dhe operacionet ndërkombëtare humanitare e aktivitete të tjera

OSMANI NË TAKIM ME HOVENIERIN: HEQJA E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE SERBE KA NDIKIM NEGATIV

F. 7



ORGANIZATA JOQEVERITARE DHE AKTIVISTË KËRKOJNË DORËHEQJEN E BORDIT TË RTK-së

F. 5



AKTUALE



HARRISI DHE TRUMPI NISIN PËRPLASJEN VERBALE

F. 2

MPJD-ja UL TARIFAT PËR SHËRBIMET KONSULLORE NË AMBASADAT E KOSOVËS

F. 5

THEMELOHEN NË GJASHTË KOMUNA ZYRA MOBILE PËR OFRIM TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

F. 6

EKONOMI



FESTIVALI TRADICIONAL I DOMATES, KURTI: DOMATJA JUAJ NË SOFRËN TONË, NGA TOKA JONË

F. 8

ODA AMERIKANE, E SHOETËSUAR PËR TRAJTIMIN E VAZHDESHËM PREFERENCIAL TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE

F. 8

SPORT



ADEMI PËRGËZON KRYETARIN GJINI PËR PROJEKTIN E STADIUMIT TË RI, PAJTOHEN PËR MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shagiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Harrisi dhe Trumpi nisin përplasjen verbale

UASHINGTON, 24 KORRIK - Nënpresidentja e Shteteve të Bashkuara, Kamala Harris, tha se zgjedhjet presidenciale të nëntorit në këtë vend do të jenë zgjedhje midis një ish-prokuroreje dhe një “kriminel të dënuar”. Me këtë të fundit, kandidatja e pritur për presidente nga Partia Demokratike iu referua kandidatit të Partisë Republikane, Donald Trump. Harris i bëri komentet në tubimin e parë të saj zgjedhor

në Uiskonsin. Një ditë më herët u bë e qartë se ajo ka mbështetjen e shumicës së delegatëve demokratë për t’u nominuar kandidate për presidente. Presidenti aktual Joe Biden i dha asaj mbështetje, pasi vetë u tërhoq nga gara për rizgjedhje më 21 korrik. Duke folur para mijëra mbështetësve në Uiskonsin, Harris e krahasoi Trumpin me, siç tha, mashtruesit që si ish-prokurore i ka ndjekur

penalisht. Gjatë fjalimit ajo parashtroi edhe një sërë prioritetesh liberale që tha se do t’i ketë nëse zgjidhet presidente, përfshirë këtu: kontrollin e armëve dhe qasjen në abort. “A duam të jetojmë në një vend të lirisë, ndjesisë dhe sundimit të ligjit, apo në një vend të kaosit, frikës dhe urrejtjes?”, tha ajo. Trumpi reagoi me një postim në rrjetet sociale, ku shkroi se “Kamala Harris gënjen” dhe “shkatërron gjithçka që prek”.



Macroni s’do ta emërojë qeverinë e re deri pas Olimpiadës



PARIS, 24 KORRIK - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, tha se nuk do ta emërojë qeverinë e re deri pas përfundimit të Lojërave Olimpikë të Parisit. Komentet vijnë pasi Fronti i Ri Popullor (NFP) - një koalicion i krahut të majtë që përbën grupin më të madh në Parlamentin francez, pas zgjedhjeve të fundit - propozoi zyrtaren pak të njohur, Lucie Castets, kandidate për

kryeministre. Duke iu përgjigjur kësaj, Macroni tha se emërimi i qeverisë së re para mesit të gushtit “do të krijonte parregullsi”. Politikanët e krahut të majtë thanë se Macroni po përpiqet “ta anulojë rezultatin e zgjedhjeve legjislative”, raundi i dytë i të cilave u mbajt më 7 korrik. Lojërat Olimpikë do të nisin të premtën dhe do të përfundojnë

më 11 gusht. Macroni e ka pranuar dorëheqjen e kryeministrit Gabriel Attal pas humbjeve të mëdha të partisë së tyre të qendrës në zgjedhje. Megjithatë, Attal dhe ministrat e tij janë pajtuar që të mbeten në detyrë, në formën e një qeverie të përkohshme, derisa të emërohen zëvendësuesit e tyre. Sipas sistemit francez, kryeministri emërohet tradicionalisht nga presidenti.

Gjermania ndalon Qendrën Islamike të Hamburgut

HAMBURG, 24 KORRIK - Autoritetet në Gjermani ndaluan të mërkurën Qendrën Islamike të Hamburgut (IZH) - një organizatë që, sipas inteligjencës vendase, kontrollohet nga Irani. Paraprakisht, policia bastisi hapësirat e saj brenda xhamisë shiite Imam Ali në Hamburg, si dhe në tetë lande të tjera. Shërbimi i inteligjencës së brendshme gjermane e klasifikoi atë organizatë ekstremiste. Sipas një deklarate të Ministrisë së Brendshme gjermane, IZH-ja

“ka përhapur në mënyrë agresive dhe militante ideologjinë e ‘udhëheqësit revolucionar’ iranian dhe të të ashtuquajturit ‘revolucion islamik’”. “Është shumë e rëndësishme për mua që të bëj një dallim të qartë këtu: ne nuk po veprojmë kundër ndonjë feje”, tha ministrja e Brendshme e Gjermanisë, Nancy Faeser. Ajo shtoi se praktikimi paqësor i besimit shiit nuk do të ndikohet nga ndalimi i organizatës IZH. Sipas deklaratës, katër xhami

shiite u mbyllën në kuadër të kësaj ndalese. Në Gjermani jetojnë rreth 150 deri në 200 komunitete shiite. IZH-ja ishte prej kohësh nën vëzhgimin e inteligjencës gjermane, e cila në raportin e saj vjetor më 2023 vlerësoi se është përfaqësuesja më e rëndësishme e Iranit në Gjermani, krahas ambasadës së këtij vendi. Shifra të besueshme për anëtarët apo mbështetësit e grupit, të themeluar në vitin 1962, nuk ka.



Senatori Menendez jep dorëheqje



NJU-XHËRSI, 24 KORRIK - Senatori amerikan Bob Menendez dha dorëheqje nga pozita pasi u dënua për korrupsion. Menendezi tha në një letër se dita e tij e fundit si senator i ShBA-së do të jetë 20 gushti. Senatori demokrat nga Nju-Xhërsi tha se planifikon ta

apelojë aktgjykimin dhe se nuk do që Senati “të përfshihet në një proces të gjatë që do ta dëmtonte punën e tij të rëndësishme”. Guvernatori i Nju-Xhërsit, Phil Murphy, gjithashtu demokrat, do të emërojë tani një zëvendësues për Menendezin, i cili ka shërbyer si senator që nga viti

2006. Ai ka qenë edhe kryetar i Komitetit me ndikim për Marrëdhënie me Jashtë, por ka hequr dorë nga ky post, pasi është akuzuar për korrupsion, vitin e kaluar. Menendez, 70 vjeç, u shpall fajtor më 16 korrik për të 16

akuzat penale me të cilat ngarkohej, përfshirë pengimin e drejtësisë, mashtrimin dhe zhvatjen. Vendimi u mor nga një juri në gjykatën federale në Manhatan, pas një gjyqi 9-javor. Në të njëjtin rast u dënuan edhe dy të bashkëpandehur.

Një tërmet godet Shqipërinë

DURRËS, 24 KORRIK - Një tërmet prej 4.6 shkallësh të Rihterit goditi Shqipërinë në orët e para të së mërkurës. Qendra Sizmologjike Evropiane e Mesdheut (EMSC) bëri me

dije se epiqendra e dridhjeve ishte në Detin Adriatik - rreth 35 kilometra nga Durrësi. Sipas burimit të njëjtë, thellësia e dridhjeve ishte 6.1 kilometra.

Raporte për dëme materiale nuk ka. Dridhjet janë ndier edhe në vendet përreth. Instituti Hidrometeorologji për dhe

Sizmologji në Mal të Zi ka njoftuar se ato janë regjistruar në orën 02:42 të së mërkurës. Rajoni i Ballkanit, përndryshe, është zonë tërmetesh. Në vitin 2019, nga një tërmet i

fuqishëm që ka goditur Shqipërinë, kanë humbur jetën 51 njerëz, ndërsa qindra të tjerë janë plagosur. Ky tërmet ka shkakuar dëme në vlerë rreth një miliard euro.

Shërbimi evropian i klimës: 21 korriku, dita më e nxehtë e regjistruar ndonjëherë

BRUKSEL, 24 KORRIK - Njëzet e një korriku ishte dita më e nxehtë e regjistruar ndonjëherë në botë, sipas të dhënave paraprake të publikuara më 23 korrik nga monitoruesi për motin i Bashkimit Evropian.

Shërbimi i Ndryshimeve Klimatike, Copernicus (C3S), tha se temperatura mesatare globale e ajrit në sipërfaqe ishte 17.09 gradë celsius të dielën, që është temperatura më e lartë e regjistruar ndonjëherë. Matjet e tyre për temperaturat kanë nisur më 1940.

Njoftimi vjen në kohën kur Evropa dhe Shtetet e Bashkuara po përballen me valë të nxehtësisë dhe zjarre.

“Toka sapo ka përjetuar ditën më të nxehtë të saj”, tha shërbimi monitorues përmes një deklaratë.

Rekordi i ri ditor, që u regjistrua ishte 0.01 gradë celsius më shumë sesa rekordi paraprak prej 17.08 i regjistruar më 6 korrik 2023. “Më 21 korrik C3S regjistroi një rekord të ri të temperaturës mesatare ditore globale”, tha drejtori i shërbimit, Carlo Buontempo. “Tani vërtet



jemi në një terren të pashkelur dhe teksa klima po vazhdon të ngrohet, ne do të kemi rekorde të tjera që do të thyhen në muajt dhe vitet e ardhshme”, tha ai.

Edhe pse shifrat e publikuara paraqesin një rritje të lehtë

krahasuar me rekordin paraprak, Buontempo tha se gjatë 13 muajve të fundit është regjistruar një nxehtësi rekord në mbarë botën.

Çdo muaj që nga qershori i vitit 2023 ka regjistruar rekord

temperature krahasuar me muajin e njëjtë në vitet e kaluara. Në këtë kontekst, Copernicus tha se nuk do të ishte e papritur që edhe ky rekord të thyhet gjatë kësaj vere. Ndryshimet klimatike po

shkaktojnë ngjarje të motit ekstrem që janë më të gjata, më të fuqishme dhe më të shpeshta, sikurse janë valët e të nxehtit, vërshimet dhe zjarret.

Këtë vit valët e të nxehtit veçse kanë goditur Amerikën e Veriut, Meksikën, Indinë dhe Tajlandën, ndërkaq vërshimet kanë shkaktuar dëme në pjesë të Afrikës Lindore, Kinës dhe Brazilit.

Vatra të zjarrit ka në pjesë të mëdha në mbarë Evropën jugore dhe lindore, por edhe në Kanada e Shtetet e Bashkuara.

Djegia e lëndëve fosile vlerësohet se është nxitësi kryesor i ngrohjes globale, po ashtu emetimet e gazrave serrë po vazhdojnë të rriten pavarësisht prej përpjekjeve ndërkombëtare që bota të kalojë në energji të pastër dhe ta ngadalësojë rritjen e temperaturave.

Viti 2023 ishte viti më i nxehtë në histori dhe viti 2024 mund të bëhet viti më i nxehtë, duke pasur parasysh “temperaturat mjaftueshëm të nxehta” që janë përjetuar deri më tani gjatë këtij viti, tha Copernicus.

Pronat e sekuestruara të Radoiçiqit i kalojnë Policisë së Kosovës

PRISHTINË, 24 KORRIK - Me ndryshim-plotësimet e një udhëzimi administrativ, të miratuara të mërkurën nga Qeveria e Kosovës, pronat e sekuestruara të biznesmenit serb nga veriu i Kosovës, Millan Radoiçiq, do t'i jepen në shfrytëzim Ministrisë së Brendshme të Kosovës, përkatësisht Policisë së Kosovës.

Radoiçiqin, Kosova e kërkon si të dyshuar për organizimin e sulmit të armatosur në fshatin Banjskë të Zveçanit, shtatorin e kaluar.

Në këtë sulm mbeti i vrarë një polic i Kosovës, ndërsa në përlëshjet e armatosura që pasuan, u vranë edhe tre sulmues serbë.

Radoiçiqi besohet se është i lirë në Serbi.

Gjatë një aksioni në prill, Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara ose të Konfiskuara e Kosovës sekuestroi dy prona të



paluajtshme në Mitrovicën e Veriut, një restaurant dhe një banesë, si dhe një vilë në komunën e Zubin Potokut - që të

gjitha në pronësi të Radoiçiqit. Duke folur në mbledhjen e qeverisë të mërkurën, ministrja e Drejtësisë e Kosovës, Albulena

Haxhiu, tha se këto prona aktualisht janë nën menaxhim të ministrisë që udhëheq ajo, përkatësisht Agjencisë për

Administrimin e Pasurive të Sekuestruara ose të Konfiskuara të Kosovës.

Haxhiu tha se ndryshimet në udhëzimin administrativ janë të rëndësishme, sepse i eliminojnë procedurat e tejzgjatura për dhënien me qira të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, kur ato i kërkon një institucion publik ose organ shtetëror.

Haxhiu tha se pronat e sekuestruara të Radoiçiqit gjenden në lokacione me rëndësi strategjike. Sipas saj, kalimi i tyre nën menaxhimin e institucioneve të sigurisë bëhet me qëllim të “rritjes së sigurisë shtetërore, territoriale dhe institucionale” në veri të Kosovës - zonë e banuar me shumicë serbe.

Pas miratimit të ndryshim-plotësimeve të udhëzimit administrativ në Qeverinë e Kosovës, Haxhiu tha se institucionet e vendit do t'i vazhdojnë procedurat e tjera.

Abdixhiku, Kurtit: Të kalosh një mandat duke ndarë e përçarë kur ka aq shumë punë, është marrëzi

PRISHTINË, 24 KORRIK - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, duke iu referuar qeverisë Kurti, ka thënë se të kalohet një mandat i plotë duke ndarë e përçarë kur ka aq shumë punë e aq shumë nevojë është marrëzi. Abdixhiku në “Facebook” ka shpërndarë një video të kryetarit të Lipjanit, Imri

Ahmeti, i cili flet për ndërtimin e çerdheve në këtë komunë. “Në vend ushqimit popullist përplot frustrim e urrejtje, në vend të sulmeve propaganduese parapartiake, ne kemi zgjedhur që kohën tonë t’ia dedikojmë gjërave që kanë rëndësi! Ndër tjerash, edhe ndërtimin e një çerdhe tjetër në Lipjan, e 5-ta tashmë! Shtëpi edukimi për 100

fëmijë! Model në plot kuptimin e fjalës! Kosova ka aq shumë potencial e ka aq pak kohë! Të kalosh një mandat të plotë duke ndarë e përçarë kur ke aq shumë punë e aq shumë nevojë, është marrëzi. Në ‘Rugën e Re’ do të ndërtojmë plot 80 çerdhe të tilla nëpër Kosovë”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”.





Qeveria ndryshon Projektligjin që dërgon FSK-në në operacione jashtë vendit

Kabineti qeveritar ka miratuar të mërkurën Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit. Ky projektligj rregullon mënyrën e procedurat e dërgimit dhe tërheqjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit, përcaktimin e marrjes pjesë në operacionet ndërkombëtare të paqes dhe operacionet ndërkombëtare humanitare e aktivitete të tjera

EPOKA E RE**MAL QORRAJ**

PRISHTINË, 24 KORRIK - Qeveria e Kosovës ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, në të cilin ka miratuar 22 vendime. Fillimisht ka miratuar Projektligjin për Banim Social të Përbalueshëm. Zbatimi i këtij ligji përfshin programin për banimin social, banimin e përbalueshëm për çiftet e reja, rindërtimin dhe renovimin e shtëpive për familjet në nevojë, si dhe përmirësimin e kushteve të lagjeve. Grupet që do të përfitojnë përfshijnë familjet me situatë ekonomike të vështirë, të papunët, të pastrehët, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, të rinjtë, komunitetet joshumicë dhe grupe të tjera të përcaktuara në projektligj.

Ka miratuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e

Ligjit për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit. Ky projektligj rregullon mënyrën e procedurat e dërgimit dhe tërheqjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit, përcaktimin e marrjes pjesë në operacionet ndërkombëtare të paqes dhe operacionet ndërkombëtare humanitare, e aktivitete tjera. Në vazhdim të mbledhjes ka aprovuar Udhëzimin Administrativ "Edukimi për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili ndërlidhet me shtyllën e parë në Strategjinë e Arsimit 2022-2026 për edukimin në fëmijërinë e hershme. Gjithashtu, ka emëruar Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Telekomi i Kosovës" Sh. A., me këtë përbërje: Petrit Nahi, kryesues; Rrezarta Pllana, anëtare; Sajmie Thaçi, anëtare; Lindita Toçi, anëtare.

Në vendimin e pestë ka emëruar

Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Kompania për Menaxhimin e Deponive" Sh. A., me këtë përbërje: Afrim Konjufca, kryesues; Emina Telaku, anëtare; Valbona Shala-Thaçi, anëtare; Petrit Pantina, anëtar. Po ashtu, ka miratuar vendimin përfundimtar për shpronësim për interes publik për nevoja të Depos Qendrore të Barnave dhe akomodim të administratës së Ministrisë së Shëndetësisë.

Ka miratuar vendimin përfundimtar për shpronësim për interes publik për nevoja të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka miratuar vendimin preliminar për shpronësimin dhe krijimin e të drejtës së servitutit për interes publik në qytetin e Malishevës.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe vendimin për shqyrtim të mëtejme të kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme për nevoja të Terminalëve Doganore: Hani i Elezit, komuna Hani i Elezit, Merdar, komuna Podujevë dhe Dheu i Bardhë, ZK Domoroc, komuna Ranillugë.

Në vendimin 10 ka dhënë në shfrytëzim për Ministrinë e Punëve të Brendshme pronat në zonat kadastrale Jesenovik i Epërm dhe Çeçevë, komuna Zubin Potok, pronë e Agjencisë Pyjore të Kosovës.

Në vendimin 11 ka themeluar Komisionin e pranimit për pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese: Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Po në këtë mbledhje ka ndryshuar dhe plotësuar vendimin e Qeverisë nr. 06/ 143 të datës 28 prill 2017 për themelimin e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar Gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr. 16/48 të datës 7 dhjetor 2020 dhe vendimin nr. 02/54 të datës 12 janar 2022.

Sipas këtij plotësimi-ndryshimi, paragrafi 9 i pikës 1 riformulohet si në vijim: Kreshnik Oseku, MFPT - anëtar. Kabineti qeveritar ka aprovuar edhe raportin vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2023.

Në vendimin e 14 ka miratuar nismën për lidhjen e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Qeverisë së Zvicrës, e përfaqësuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim për Programin

"Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore në Kosovë Faza 2".

Qëllimi i këtij programi është ta mbështesë Kosovën të themelojë një kornizë të integruar funksionale për mbrojtjen, cilësinë dhe përdorimin e qëndrueshëm dhe ndarjen e barabartë të burimeve ujore në Kosovë.

Në vendimin 15 ka miratuar koncept-dokumentin për Veprimtari Kërkimore, Shkencore dhe Inovacion. Ky dokument rrjedh nga Programi Kombëtar i Shkencës 2023-2028, i miratuar vitin e kaluar. Një ndër objektivat kryesore të Programit është zhvillimi i një sistemi efektiv të kërkimit shkencor dhe inovacionit përmes konsolidimit të kornizës ligjore.

Po ashtu, ka themeluar Komisionin ad hoc për vlerësimin profesional për kategorinë e lartë drejtuese për Sekretar të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Ka aprovuar raportin gjashtëmuor financiar për vitin 2024 dhe ka themeluar bordin këshillimor shkencor lidhur me ndryshimet klimatike.

Në vendimin 19 ka rialokuar 3 milionë euro për 55 projekte kapitale nëpër komuna.

Gjithashtu, ka plotësuar dhe ndryshuar vendimin e Qeverisë

Organizata joqeveritare dhe aktivistë kërkojnë dorëheqjen e Bordit të RTK-së

PRISHTINË, 24 KORRIK - Pas situatës së krijuar me rastin e publikimit të artikullit “Slobodna Bosna” (Bosnja e Lirë), të transmetuar në RTK, 19 organizata joqeveritare dhe aktivistë kanë kërkuar dorëheqjen e Bordit të RTK-së për mungesë të pavarësisë dhe profesionalizmit në ushtrimin e mandatit të tyre. Lëvizja FOL, e cila është bartëse e kësaj iniciative, ka njoftuar se Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka ripublikuar një informacion dezinformues me qëllim që t'i sulmojë mediet online Nacionale dhe Persikopi, me pretendimin që kontrollohen nga Serbia. “Kjo narrativë e ushqyer ndër vite nga partia në pushtet Lëvizja Vetëvendosje ka për qëllim denigrimin e gazetarëve dhe cytjen e qytetarëve kundër tyre, gjë që përbën rrezik për sigurinë e tyre. Në vend se të suspendonte të gjithë përgjegjësit për lëshimin e kësaj dezinformate, Bordi i RTK-se u mjaftua me një shprehje të ‘keqardhjes’ për artikullin në fjalë dhe formimin e një komisioni për të ‘sqaruar situatën’ duke mos u distancuar apo kërkuar falje”, thuhet në njoftimin e Lëvizjes Fol Sipas këtij njoftimi, është tejte shqetësues fakti që artikullin

dezinformues të publikuar nga RTK-ja, bordi e ka cilësuar “kontravers” dhe ka deklaruar të pavërteta se, kinse, RTK-ja nuk ka përmendur emrat e medimeve. “Kjo është bërë për ta zbutur kështu skandalin që i ka ndodhur transmetuesit publik dhe duke anashkaluar faktin se ky lajm bie në kundërshtim me Ligjin e RTK-së, Statutin e RTK-së dhe Standardet Profesionale. Formimi i komisioneve është metodë e njohur që përdoret për të tej zgjatur procedurat me shpresën që publiku do të harrojë”, thuhet në këtë njoftim, duke shtuar se përtej ngjarjes së fundit, një sërë zhvillimesh tjera kanë ndodhur në RTK që japin indikacione të qarta që bordi i transmetuesit nuk funksionon më i pavarur nga partia në pushtet. “Këtu përfshihen detyrimi i ish drejtorit gjeneral Shkumbin Ahmetxhekaj që të dorëhiqet dhe ushtrimi i presionit ndaj tij, krijimi i një praktike të publikimit të informacioneve që shkelin standardet etike dhe ligjore siç ishte informacioni për dyshimet për atentate ndaj udhëheqësve të pushtetit, publikimi i videove të ndryshme që i ndihmojnë narratives qeveritare e deri tek



lajmet si ky i fundit që për qëllim nuk e kanë informimin e publikut por bërjen e propagandës pro qeveritare. Rrjedhimisht, ne konsiderojmë që bordi i RTK-së duke bërë lëshime të njëpasnjëshme ka lejuar shtrirjen e dorës së pushtetit në transmetuesin

publik dhe nuk gëzon më kredibilitetin dhe pavarësinë e nevojshme për të vazhduar tutje mandatin e tyre dhe duhet të dorëhiqen nga pozitat e tyre. Njëkohësisht i bëjmë thirrje Lëvizjes Vetëvendosje që të ndalë luftën e ashpër kundër mediave dhe gazetarëve që ka rezultuar

me rënien e Kosovës 19 vende në indeksin e Reporterëve pa Kufij”, ka njoftuar Lëvizja FOL. Edhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës u bashkohet organizatave joqeveritare dhe aktivistëve në kërkesën për dorëheqjen e Bordit të Radio Televizionit Publik të Kosovës.

MPJD-ja ul tarifat për shërbimet konsullore në ambasadat e Kosovës



PRISHTINË, 24 KORRIK - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka bërë me dije se kanë ulur ndjeshëm tarifat për shërbimet konsullore në ambasadat e Kosovës. Ajo ka shtuar se ulja e këtyre tarifave ka ardhur pas analizimit të tyre ku kanë parë se të njëjtat kanë qenë shumë të larta. “Pasi kemi analizuar me kujdes tarifat e deritanishme për shërbimet konsullore dhe kemi konstatuar se shumica prej tyre jo vetëm që janë mjaft më të larta sesa shërbimet e njëjta brenda Kosovës, jam e lumtur dhe krenare që sot mund të paraqes para jush një strukturë të re të tarifave konsullore e cila përbën jo vetëm një ulje të dukshme të këtyre tarifave por, njëkohësisht, mënjanon edhe disa anomalitë panevojshme si p.sh pagesat e larta për dokumente të cilat, në fakt, ndodhen brenda sistemit me të cilin shërbehen konsullatat tona. Po t'i shtojmë

kësaj edhe faktin që në Gjermani, në shtetin në të cilin jeton numri më i madh i mërgimtarëve tanë, tashmë ka hyrë në fuqi, në fund të qershorit, edhe Ligji për Dyshtetësi. Pra është bërë edhe më urgjente jo vetëm nevoja për uljen e tarifave për rifitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës, por edhe të thjeshtësimin të procedurave për rifitim të shtetësisë. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se sa i vështirë dhe sa i dhimbshëm ka qenë për ata mbi 50 mijë qytetarë të Republikës së Kosovës të cilët, në mungesë të alternativave të tjera, e kanë dorëzuar shtetësinë e Republikës së Kosovës për ta marrë atë gjermane. Konsullatat tona ju presin krah-hapur të gjithëve për të aplikuar sa më shpejt dhe pa burokraci të panevojshme për rifitimin e shtetësisë. Ju njoftoj se për rifitimin e shtetësisë tarifa është zero”, ka thënë Gërvalla gjatë një konference për medie.

nr. 02/58 i dt. 2 shkurt 2022 i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin nr. 01/166 të dt. 15 tetor 2023, me qëllim për ta harmonizuar përbërjen e bordit me legjislacionin në fuqi për barazinë gjinore, e për ta mundësuar ushtrimin e plotë të kompetencave të KEK. Në vendimin 21 ka plotësuar dhe ndryshuar Udhëzimin

Administrativ për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 13/2022 për Mënyrën dhe Procedurat e Shitjes dhe Dhënies me Qira të Pasurisë së Luajtshme dhe të Paluajtshme të Sekuestruar dhe të Konfiskuar. Ky udhëzim rregullon të drejtën e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së

Sekuestruar dhe të Konfiskuar që të japë me qira në fazën e sekuestrimit pasuritë e paluajtshme pa ankand publik, nëse pasuritë e paluajtshme i kërkon një institucion publik ose organ shtetëror. Shkurtimi i procedurave të dhënies me qira të pasurive të paluajtshme pa ankand publik në fazën e sekuestrimit është

bërë me qëllim të përshpejtimit të kalimit të pronës së paluajtshme nga Agjencia në shfrytëzim të institucionit publik që e kërkon atë, për shkak se disa pasuri që tashmë janë sekuestruar, gjenden në disa pika strategjike të territorit tonë, konkretisht në veri të vendit. Shfrytëzimi dhe menaxhimi i tyre nga

institucionet e sigurisë është i rëndësishëm nacional dhe i kontribuon rritjes së sigurisë territoriale në përgjithësi. Në fund të kësaj mbledhje ka emëruar Komisionin ad-hoc të Pranimit për Kategorinë e Lartë Drejtuese: Drejtor (ekzekutiv) i Përgjithshëm në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.

Themelohen në gjashtë komuna zyra mobile për ofrim të ndihmës juridike falas

PRISHTINË, 24 KORRIK - Në Podujevë, Klinë, Vushtrri, Lipjan, Shtime dhe Rahovec qytetarët do të kenë qasje në ndihmën juridike falas përmes zyrave mobile. Kështu ka bërë

me dije ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu. “Sot kam nënshkruar vendimin për themelimin e gjashtë zyrave mobile në komunën e Podujevës, Klinës, Vushtrrisë, Lipjanit,

Shtimes dhe Rahovecit për t’ju ofruar kështu qytetarëve qasje direkte në ndihmën juridike falas përmes këtyre zyrave. Shtirja e ndihmës juridike falas, qasja në drejtësi dhe mundësitë

e barabarta për qytetarët janë qëllim i yni andaj hapja e këtyre zyrave është një hap shumë i rëndësishëm për plotësimin e tyre”, ka shkruar Haxhiu në “Facebook”.



Osmani ia dorëzoi Medaljen Presidenciale të Meritave rock grupit “Oda”

PRISHTINË, 24 KORRIK - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, në një ceremoni të mbajtur në Presidencë, ia ka dorëzuar Medaljen Presidenciale të Meritave rock grupit “Oda” për promovimin e vlerave muzikore si pjesë e gjeneratës së artë të rockut në Kosovë.

Në emër të grupit, medaljen e ka pranuar Dukagjin Lipa, i cili e ka falënderuar presidenten Osmani për dekoratën.

Presidentja Osmani ka theksuar se “Oda”, sikurse edhe grupe të tjera të viteve ’80, ishin jo vetëm interpretues, por edhe katalizatorë të ndryshimeve shoqërore. “Muzika e ‘Odës’ është emblema e identitetit kulturor dhe krenarisë për Kosovën. Krijimtaria muzikore e tyre vazhdon të jetë dëshmi e fuqisë

transformuese të artit në kohë dhe periudha të ndryshme duke u shndërruar po ashtu në një mjet rezistence”, ka theksuar Osmani. Medalja Presidenciale grupit “Oda” i është ndarë një vit më parë në një ceremoni në të cilën janë nderuar edhe rock grupe të tjera të asaj periudhe, sikurse edhe institucione e personalitete të tjera të cilat kanë kontribuar ndër vite.

Vlen të theksohet se kjo ceremoni u mbajt në prag të fillimit të Sunny Hill Festival.

Në pamundësi për të qenë prezent për shkak të agjendës ndërkombëtare, Osmani i përgëzoi Lipën, Dua Lipën dhe Sunny Hill Foundation për punën e shkëlqyer duke i uruar që ky edicion të jetë një tjetër sukses i jashtëzakonshëm.



Nënshkruhen procedurat standarde të veprimit të Zyrës për Rikthim të Aseteve



Prishtinë, 24 korrik - Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, në prani të udhëheqësit të Zyrës për Rikthim të Aseteve, prokurorit të shtetit, Bahri Hyseni dhe përfaqësuesve të institucioneve ligjzbatuese që janë pjesë e kësaj zyre si Policia e Kosovës, Njësi për Inteligjencë Financiare, Agjencia për Menaxhimin e Aseteve të Konfiskuara dhe të Sekuestruara, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës kanë nënshkruar të mërkurën procedurat standarde

të veprimit për Zyrën për Rikthim të Aseteve, e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Me këtë rast, ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka theksuar se me nënshkrimin e këtyre procedurave po kompletohet infrastruktura ligjore për funksionimin e plotë të Zyrës për Rikthim të Aseteve, procedura këto që do t’u shërbejnë të gjithë prokurorëve në rastet kur ka vend për rikthim të asetëve.

Procedurat standarde të veprimit

përshkruajnë mënyrat dhe procedurat që duhet të ndiqen për funksionimin sa më efikas të Zyrës për Rikthim të Aseteve, me qëllim të ofrimit të ndihmës dhe këshillave për prokurorët e shtetit si dhe partnerët ndërkombëtarë në rastet e rikthimit të asetëve dhe bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar.

Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë edhe partnerët ndërkombëtarë nga Ambasada e ShBA-së, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, Zyra e BE-së dhe Zyra e UNDP-së në Kosovë.

Prokuroria Speciale ngre aktakuzë kundër gjashtë personave për shpëlarje të parave

PRISHTINË, 24 KORRIK - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur të mërkurën aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin Special, kundër të pandehurve E. K., Xh. Xh., A. H., R. B., M. V. dhe F. T., pasi ekziston dyshimi i bazuar mirë se të njëjtët kanë kryer veprën penale të kryer në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga viti 2015

deri në vitin 2023, “Shpëlarja e parave”, e përcaktuar me nenin 308, lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së dhe nenin 56, par. 1, pika 1.6 të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Ndërkaq, për të pandehurit E. K. dhe M. V., po ashtu, ekziston dyshimi i bazuar mirë se ata kanë kryer edhe veprën penale në

bashkëkryerje “Falsifikimi i dokumenteve”, e përcaktuar me nenin 390, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Vlera pasurisë së sekuestruar në këtë rast është 1,629,929.77 euro., për të cilën Prokuroria Speciale i ka propozuar Gjykatës që ta bëjë konfiskimin e saj.

Ky rast ka qenë i shënjestruar dhe i emërtuar “Zhuri”.



Dy autoambulanca të reja i shtohen QKMF-së në Ferizaj

FERIZAJ, 24 KORRIK - Komuna e Ferizajt ka siguruar dy autoambulanca të reja për Qendrën Kryesore të

Mjekësisë Familjare. Kryetari i komunës, Agim Aliu, është shprehur se ky është investim i rëndësishëm

së veçantë që po realizohet për herë të parë. “Përmes tyre po rrisim ndjeshëm edhe

cilësinë e shërbimit dhe shpejtësinë e reagimit në raste emergjente”, ka shkruar ai në “Facebook”.



Kurti: Faton Hajrizi nuk duhet të shihet si hero, nevojitet hetim vendor dhe ndërkombëtar për rastin e tij

PRISHTINË, 24 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në mbledhjen e qeverisë të mërkurën, ka folur për rastin e shtetasit Faton Hajrizi, i cili është raportuar i vrarë disa ditë më parë në Serbi. Kurti ka kërkuar hetim vendor dhe ndërkombëtar për ndriçimin e këtij rasti.

Ai i ka ftuar qytetarët të mos bien pre e euforisë së heroizimit dhe romantizimit të Faton Hajrizit. "Ditëve të fundit kemi dëgjuar shumë lajme në lidhje me rastin e shtetasit Faton Hajrizi. Institucionet tona janë përpjekur maksimalisht që në vazhdimësi të transmetojnë informacione zyrtare. Së fundmi, përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës jemi informuar nga Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar Policor - ILECU e Policisë së Kosovës se autoritetet serbe, më datë 22 korrik 2024, kanë dërguar shenjat e gishtërinjve të një personi. Të njëjtat shenja së bashku me shenjat e gishtërinjve të qytetarit të



Kosovës, Faton Hajrizi, janë përcjellë në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë (AKF), ku pas krahasimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar

Policor ka pranuar përgjigje se këto gjurmë i përkasin qytetarit të raportuar si i vrarë. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës kanë përcjellë me vëmendje çdo hollësi.

Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Punëve të Jashtme janë angazhuar dhe kanë informuar. Megjithatë, sqarimi i rrethanave që nga ikja në drejtim të Serbisë e deri te vrasja

e tij e raportuar kërkon një hetim vendor dhe ndërkombëtar. Ndërkohë, i ftoj qytetarët e vendit tonë të mos bien pre e euforisë së heroizimit dhe romantizimit të Faton Hajrizit. Patriot në Republikën e Kosovës është rreshteri i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, i vrarë në Banjaskë të Zveçanit", ka thënë Kurti.

Ai ka shtuar se patriotë janë 23 pjesëtarët e Policisë së Kosovës të rënë në krye të detyrës, që dëshmuar përkushtimin për shërbim deri në sakrificë. "E pikërisht këtë javë, 26 korrikun, për të tretin vit radhazi, e shënojmë si Ditë Memoriale të Policëve të Rënë në Kryerje të Detyrës. Datë kjo e cila përkon me rënien e një patrioti tjetër të ditëve tona, heroit Enver Zymeri, që u vra në krye të detyrës në Zubç të Zubin Potokut më 2011. Andaj edhe sot, si çdo ditë e çdo mot, e ripërsëris thirrjen tek organet përgjegjëse për zbardhjen e të gjitha këtyre rasteve dhe sjelljen e autorëve para drejtësisë", ka thënë Kurti.

Osmani në takim me Hovenierin: Heqja e vizave për mbajtësit e pasaportave serbe ka ndikim negativ

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 KORRIK - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur në takim të rregullt ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jeffrey Hovenier. Në takim është diskutuar për pjesëmarrjen e presidentes në aktivitetet në kuadër të Samitit të NATO-s, me ftesë të presidentit Joe Biden dhe sekretarit të Shtetit Antony Blinken, respektivisht. Duke e vlerësuar ftesën e ShBA-së dhe praninë e Kosovës në këto aktivitete kyçe të Samitit si një zhvillim strategjik në dobi të



avancimit dhe ruajtjes së paqes dhe sigurisë në rajon dhe përtej,

presidentja Osmani potencoi impaktin pozitiv që do të kishte

anëtarësimi i Kosovës në NATO për paqen dhe sigurinë e qëndrueshme dhe afatgjatë. Presidentja Osmani dhe ambasadori Hovenier diskutuan edhe për takimet e fundit të presidentes me zyrtarë të lartë amerikanë, si dhe për hapat konkretë që duhet të ndërmerren në vijim sa i përket koordinimit të veprimeve në dobi të interesave të Kosovës dhe të partneritetit me ShBA-në. Duke folur për zhvillimet e fundit në vend, presidentja shprehu shqetësimin për vendimin e djeshëm të Këshillit të Bashkimit Evropian për t'ua

hequr regjimin e vizave qytetarëve të Kosovës që kanë pasaporta ilegale serbe, duke theksuar se ky vendim ndikon negativisht në shtrirjen e sundimit të ligjit në gjithë Kosovën si dhe atakon përpjekjet për integrimin e komunitetit serb në Kosovë. Presidentja Osmani dhe ambasadori Hovenier diskutuan edhe për një sërë nismash ligjore që po trajtohen nga institucionet kohën e fundit, me ç'rast konfirmuan rëndësinë që të garantohej respektimi i parimeve demokratike dhe standardeve më të larta për të drejtat e njeriut.

MD-ja refuzon ta emërojë gjykatësin serb të Kushtetueses noter

PRISHTINË, 24 KORRIK - Ministria e Drejtësisë e Kosovës ka refuzuar ta emërojë gjykatësin e Gjykatës Kushtetuese, Radomir Laban, noter, pas pranimit të informacioneve nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) lidhur me integritetin e tij. Laban, paraprakisht, ishte rekomanduar nga Komisioni për përzgjedhjen e noterëve, që funksionon në kuadër të Ministrisë. Këtë e konfirmoi për Radion Evropa e Lirë,

Genc Nimoni, shef i kabinetit të ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu. Noterizimi është proces zyrtar i parandalimit të mashtrimeve, që siguron palët e përfshira në një marrëveshje apo transaksion, se dokumenti i tyre është autentik. Kosova për vite me radhë ka pasur mungesë të noterëve. Mbi 15 komuna kanë qenë fare pa noterë. Deri më tani numri i noterëve

në të gjithë Kosovën, sipas Odës së Noterëve, ishte 49. Ata janë emëruar në vitin 2012 dhe që nga ajo kohë nuk ka pasur emërim të reja. Sipas Ligjit për Noterinë, numrin e noterëve dhe selitë e tyre i përcakton Ministria, ashtu që për territorin e një komune përcaktohet së paku një noter, por kjo mund të rritet me vendim të ministrisë, ashtu që për çdo 10 000 banorë të përcaktohet një noter.



Oda Amerikane, e shqetësuar për trajtimin e vazhdueshëm preferencial të ndërmarrjeve publike

PRISHTINË, 24 KORRIK - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë shpreh shqetësimin e saj të thellë lidhur me vazhdimin e trajtimit të favorizuar të ndërmarrjeve publike nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës të cilat cenojnë parimet e konkurrencës së lirë dhe ekonomisë së tregut në kundërshtim me aktet juridike të shtetit. “Përgjatë viteve të kaluara - specifikisht në 2016, 2019 dhe 2020 - Oda Amerikane ka shprehur shqetësimin e saj lidhur me diskriminimin që u është bërë ndërmarrjeve private në favor të ndërmarrjeve publike, respektivisht aplikimin e gabueshëm të dispozitave për blerjet ‘brenda shtëpisë’ përmes të cilave autoritetet publike blejnë shërbime nga ndërmarrjet publike në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe Ligjin e Prokurimit Publik”, thuhet në reagimin e kësaj ode. Oda Ekonomike Amerikane ka



theksuar se shqetësues vazhdon të jetë promovimi direkt i shërbimeve dhe produkteve të operatorit shtetëror të telefonisë mobile në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike. “Oda Amerikane rikujton hisedarët shtetërorë se Neni 13 i këtij Ligji,

respektivisht paragrafi 13.1 e thotë në mënyrë të qartë se të gjitha ndërmarrjet publike si dhe zyrtarët dhe drejtorët e tyre, pa asnjë përjashtim, u nënshtrohen ligjeve, rregulloreve dhe akteve nënligjore të cilat i rregullojnë shoqëritë tregtare në pronësi private”, thuhet në reagim.

Oda Amerikane ka njoftuar se ka përcjellë veprimet e zyrtarëve më të lartë të qeverisë, përfshirë kryeministrin, të cilët qartazi kanë promovuar produktet e kësaj ndërmarrje publike para qytetarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës, në kundërshtim me dispozitat e ligjit që rregullon funksionimin e ndërmarrjeve publike. “Favorizimet direkte dhe indirekte të kësaj ndërmarrje publike kundrejt operatorit privat, respektivisht një investitori të huaj, në një treg të rregulluar, përbëjnë shkelje jo vetëm të dispozitave të ligjit të sipërcekur, por edhe të aktit më të lartë juridik - Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila parasheh që bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës është ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë. Brengosës është edhe mosveprimi i Autoritetit të Konkurrencës dhe organeve të

tjera ligjzbatuese në Kosovë, për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kushtetueshmërisë në Republikën e Kosovës”, theksohet tutje në reagim. Në përmbyllje, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë u bënë thirrje edhe një herë të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës, që ta ndërpresin menjëherë praktikën e favorizimit të ndërmarrjeve publike dhe diskriminimit të ndërmarrjeve private dhe investitorëve të huaj në vend, në kundërshtim me dispozitat kushtetuese e ligjore. “Secili veprim ndryshe i autoriteteve publike të cilat kanë përgjegjësi për ofrimin e mjedisit të barabartë për të gjithë operatorët ekonomik, privatë dhe publikë, do të rëndojë më tej klimën e të bërit biznes në vend dhe do të cenojë prospektet e Kosovës për tërheqjen e investimeve të huaja direkte”, thuhet në reagimin e kësaj ode.

Festivali tradicional i domates, Kurti: Domatja juaj në sofrën tonë, nga toka jonë



Mamushë, 24 korrik - Me rastin e shënimit të edicionit të 15 të hapjes së Festivalit Ndërkombëtar të Domates, kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku dhe ministri i Zhvillimit Rajonal, Fikrim Damka, mori pjesë në hapjen tradicionale të këtij festivali. Atje u mirëprit nga kryetari i komunës së Mamushës, Abdulhadi Krasniç. I pranishëm ishte edhe kryetari e komunës së Ankarasë, Mansur Yavas. Fjalën kryeministri Kurti e filloi duke shprehur ngushëllimet e tij

të thella me rastin e ndarjes nga jeta të ish-kryetarit dhe iniciatorit të Festivalit të Domates, Arif Bytyq. Ai vazhdoi duke i vlerësuar fermerët e Mamushës si punëtorë të zotë dhe shembull i mirë për Kosovën. Më tutje, ai shtoi se kur flitet për Mamushën, njëkohësisht flitet për njerëz punëtorë që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në kultivimin e produkteve më cilësore dhe me prodhimtarinë më të madhe në vend. Sa i përket përkrahjes nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në këtë rast përmes

Ministritë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kryeministri nënvizoi se fermerët e Mamushës kanë përfituar mbi 10 milionë euro nga viti 2021 deri në vitin 2024. Kurti ka theksuar se kjo mbështetjeje ka ndikuar në rritjen e sasisë prodhuese, sidomos të domates, sipërfaqet e së cilës janë shtuar për 100 % në krahasim me vitin 2021, gjë që ka rritur eksportin në vlerë për mbi tetë herë, dhe sasinë, mbi gati tetë herë. “Ajo çka synojmë si qeveri është ta shtojmë mbështetjen dhe ngritjen e vlerës së prodhimeve tona bujqësore,


në këtë rast sidomos të domates përmes skemës së granteve. Në këtë fazë ne kemi përkrahur shtimin e sipërfaqeve me serra, veçanërisht në Mamushë, falë organizimit dhe punës suaj, e kjo nënkupton prodhim më shumë. Uroj që në vitet në vijim ta shtoni gamën e nënprodukteve përmes ruajtjes dhe përpunimit”, tha kryeministri, duke shtuar se: “Domatja juaj në sofrën tonë, nga toka jonë!”. Përveç zgjerimit të sipërfaqeve me domate, kryeministri Kurti përmendi edhe shtimin e sipërfaqeve me serra, me anë të mbështetjes nëpërmjet granteve

nga Qeveria e Republikës së Kosovës, veçanërisht në Mamushë, ku puna, përkushtimi i fermerëve, organizimi si dhe prodhimtaria është në masë më të madhe. Ai theksoi se investimet në rrugën e “Bashqeve” përmes Ministritë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në Shtëpinë e Kulturës përmes Ministritë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, janë investime të tjera shtesë që gradualisht, por sigurt, do t'i bëjnë Mamushën dhe Kosovën vende të begata përmes vlerësimit të punës dhe njerëzve punëtorë.

Harrojini gënjeshttrat e Shekspir: Makbethi ishte mbreti i mirë i cili e bashkoi Skocinë

Nga: Val MCDERMID, shkrimtare / *The Daily Telegraph*

Më duhet të pranoj se gjithmonë më është dukur i bezdisshëm portretizimi i Shekspir [William Shakespeare] i Zonjës Makbeth. Është një nga gratë e pakta vërtet kryesore në veprën e tij, dhe ajo është e hidhur, shterpë – e çmendur. Për më tepër, qëndrimi i Shekspir nuk është thjesht stereotip: është shpifje.



Gruoha në portretin e John Singer Sargentit të vitit 1889 – aktorja Ellen Terry si Zonja Makbeth

Kohët e fundit, Shtëpia Botuese Birlinn kërkoi nga unë të shkruaja për Zonjën Makbeth për serinë e saj Tregime nga toka e errët [Darkland Tales], në të cilën romancierët bashkëkohorë – si Denise Mina dhe Alan Warner – futen në ngjarjet e neglizhuara ose të keqkuptuara të historisë skoceze. (Shumica prej nesh, për historinë e vendit tonë nuk mësuam diçka tjetër përtej Robert Bruceit dhe merimangës së tij.) Në fillim mendova se mund ta ritregoj historinë e saj si përrallë të shekullit XXI, për ndërskamcat politike të prapashpinës, por duke pasur parasysh gjendjen momentale të politikës në Skoci, do të ishte mënyrë e lehtë për njerëzit që ta kuptojnë jehonën e realitetit: nuk dua ta kaloj pjesën tjetër të jetës time në gjykatat e shpifjes. Kështu që vendosa të rikthehem

te mbretëresha e vërtetë e shekullit XI, Gruoh [Gruoch ingen Boite], e cila ishte gruaja e mbretit Makbeth [Macbethad mac Findláech].

Lindi rreth vitit 1015 dhe vetë ajo ishte në linjën e trashëgimisë si pasardhëse e të madhit Keneth Mekalpin [Cináed mac Ailpin] – mbretit të piktëve. Burri i saj i parë ishte Gajl Koemgejn [Gille Coemgáin], mormaer (ose kont) i provincës së Moreit. Vdiq në vitin 1032 në një zjarr në sallën e tij të madhe, së bashku me 50



bazën për atë që ne tani e mendojmë si Skocia moderne. Ai nuk ishte, si te Shekspiri, tirani i cili u largua nga froni pothuajse menjëherë pasi u ul në të. Makdufi [Macduff] – dikush nga i cili jam magjepsur qëkur luaja në rrënojat e kështjellës së tij si fëmijë në Fifë – nuk e vrau Makbethin në jetën reale dhe nuk ka asnjë bazë historike për idenë se Makbethi ia masakroi atij familjen. Në vend të kësaj, Makbethi dhe Gruoha sunduan mbretërinë e re për 17 vjet, dhe ka shumë arsye për të besuar se ishin të dashur nga njerëzit e vet. Mbretëria ishte aq e sigurt saqë, në fakt, në vitin 1050 të dy ata u larguan për disa muaj në një pelegrinazh në Romë për të takuar Papën, duke e lënë vendin në duart e një regjenti: kur u kthyen, ai ishte ende atje duke i pritur. Gjatë gjithë historisë kam vënë re se mbretërimet më të suksesshme pothuajse gjithmonë kanë qenë të rrënojësura në martesën ose në marrëdhënien e fortë: në çiftin që punon bashkërisht. Shtetasit e Makbethëve nuk u ngritën dhe nuk u revoltuan kundër tyre. Ishte djali i Dankënit, Malkolmi [Malcolm], ai i cili u kthye me pretendimin e tij mbi mbretërinë dhe trupat

e të cilit vranë Makbethin në Betejën e Lumphananit në vitin 1057. Edhe pse Shekspiri në pjesën më të madhe e paraqet Zonjën Makbeth si të paaftë për t'ia siguruar burrit një trashëgimtar, Makbethi ashiqare e cilësonte Lulahun [Lulach], djalin e Gruohës nga martesë e saj e parë, si pasardhës të vetin; Lulahu merr detyrën si mbret, megjithëse Malkolmi arriti ta vriste brenda pak muajve për t'u bërë Mbreti Malkolmi III. Nuk e dimë se kur vdiq Gruoha, por në romanin tim Mbretëresha Makbeth [Queen Macbeth], e imagjinoj atë të jetojë, duke u cilësuar nga Malkolmi si figurë potencialisht e rrezikshme e cila ende e kishte mundësinë për të bashkuar njerëzit kundër tij. Shmanga me shumë kujdes leximin e interpretimeve të tjera letrare të Zonjës Makbeth – përfshirë romanin e Dorothy Dunnett, Mbret tash e tutje [King Hereafter], të cilin e kisha shijuar shumë vjet më parë – dhe thjesht u përpoqa të imagjinoja se çfarë lloj personi ka mundur të jetë ajo për të arritur atë që bëri. Ishte gjë e mirë që pata shansin për të dhënë versionin e vërtetë të ngjarjeve, ose pothuajse të

vërtetë. Duhet të kujtojmë se në kohën e Shekspir, kompanitë teatrore varehin nga patronazhi i oborrit mbretëror dhe Makbethi u vu në skenë atëherë kur Mbreti Xhejms VI [James VI] i Skocisë u ngjiti në fronin anglez si Xhejmsi I: nuk vinte nga linja e pasardhësve të Makbethit, por nga ajo e Bankos [Banquo] gjë që shpjegon se pse Shekspiri e paraqiti Makbethin si vrasësin e neveritshëm të Bankos. Përkthimi i Zonjës Makbeth si magjistare do ta kishte kënaqur Xhejmsin i cili shkroi me obsesion për dënimin e shtrigave dhe i cili kishte djegur shumë gra si shtriga në Skoci.

Një aspekt lehtësues dhe mbrojtës për Shekspirin ishte se ai dinte më pak për Mesjetën sesa ne. Dhe, përveç kësaj, e di se sa e lehtë është t'i marrësh gjërat gabim. Komploti i librit tim varet nga personazhet të cilët njëri-tjetrit ia dërgojnë shënimet sekrete; pasi shkrova draftin e parë, botuesi im vuri në dukje se nuk kishte letër në Skoci në shekullin XI. Për fat të mirë, gjatë darkës me gruan time Jo dhe me shoqen tonë Nicola Sturgeon, arritëm të rrugëdalja nga problemi. Secili prej nesh ende pretendon atë për çfarë ka menduar. Botuesi pyeti gjithashtu nëse xhenxhefili (i përmendur në një kapitull si kurë për të vjellat e shtatzënisë) ka qenë i disponueshëm në Skocinë e Gruohës, por u konsultova me Mary Beardin e cila tha se të paktën kjo ekziston si mundësi.

Ekspozimi i mashtrimit të Shekspir nuk është punë pa rreziqe. Dy ditë përpara se në maj të flisja për librin tim në Festivalin Letrar të Stratfordit, në hotelin ku po zhvillohej ngjarja ra një zjarr. Në minutën e fundit u zhvendos në Kishën e Trinisë së Shenjtë, ku është varrosur Shekspiri. Isha duke performuar disa metra larg varrit të tij, kur papritmas ra një pjesë e madhe e muraturës së kishës. Fatmirësisht, ishte në pjesën e pasme të naosit dhe askush nuk u lëndua. Ndoshta Shekspiri sinjalizonte mosmiratimin e tij – por, preferoj ta mendoj paksa si një formë e pranimit të pendimit. /Përkthimi: Telegrafi.com



Rrënojat e kështjellës së Makdufit në Fifë



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sylvinho, trajner i Shqipërisë deri në vitin 2025

TIRANË, 24 KORRIK - Federata Shqiptare e Futbollit edhe zyrtarisht ka njoftuar se në krye të shtabit teknik të kombëtares do të jetë braziliani Sylvinho. Sipas FShF-së, ai dhe zëvendësit e tij, Pablo Javier Zabaleta Girod dhe Dorival Guidoni Junior, do të jenë në

krye të detyrës deri në dhjetorin e vitit 2025. “Nën drejtimin e trajnerit Silvinjo, kombëtarja shqiptare ka treguar progres dhe qëndrueshmëri të jashtëzakonshme. Shqipëria u kualifikua për herë të dytë në histori në një Kampionat Evropian, ku tregoi

performancë të denjë dhe bindëse në takimet kualifikuese si dhe u përballë denjësisht me kundërshtarë të nivelit të lartë në Euro 2024 ndaj Italisë, Kroacisë dhe Spanjës”, thuhet në njoftim. Ish-futbollisti i Manchester Cityt, Barcelonës e Arsenalit, i

ka drejtuar “Kuqezinjtë”, drejt suksesit historik. Kombëtarja shqiptare u kualifikua për herën e dytë në një kampionat evropian. Edhe pse me kundërshtarë tepër të fortë si: Spanja, Kroacia dhe Italia, Shqipëria tregoi lojë solide në “Euro 2024”.



Ademi përgëzon kryetarin Gjini për projektin e stadiumit të ri, pajtohen për memorandum bashkëpunimi

GJAKOVË, 24 KORRIK - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, në shoqëri të anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, Ismajl Ajeti e Agim Nura, kanë vizituar qytetin e Gjakovës. Ata janë pritur nga kryetari i komunës, Ardian Gjini. Qëllimi i kësaj vizite ishte inspektimi i punimeve për ndërtimin e stadiumit të ri në Gjakovë, një projekt që pritet të sjellë përfitime të mëdha për futbollin e Kosovës. Presidenti Ademi theksoi se stadiumi në Gjakovë është një projekt modern dhe po ndërtohet sipas standardeve më të larta të ndërtimit dhe si rrjedhojë do të

jetë një stadium i kategorisë së katërt të UEFA-s. “Ky stadium, me kapacitet prej 14 500 ulësesh, do t'i plotësojë të gjitha kriteret për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare, duke përfshirë edhe ato të Kombëtares A. Në vitin 2026 stadiumi do ta mirëpresë ndeshjen e parë të Kombëtares, pavarësisht nëse ajo do të jetë miqësore apo zyrtare”, ka theksuar presidenti Ademi. Ai e përgëzoi kryetarin Ardian Gjini për përkushtimin dhe punën e jashtëzakonshme për realizimin e këtij projekti madhor. Ai theksoi se projekti filloi me fonde lokale dhe tani po vazhdon me mbështetjen e



ministrit, duke nënvizuar përkushtimin e kryetarit Gjini që nga fillimi e deri më tani për realizimin e këtij projekti.

Gjatë kësaj vizite Ademi e Gjini

u pajtuan për nënshkrimin e një memorandum bashkëpunimi për ndërtimin e një fushe ndihmëse, sipas modelit që tash e disa vjet FFK-ja ka me

komunat, ku komuna e Gjakovës do t'i kryejë procedurat bazë, ndërsa FFK-ja do ta ndërtojë fushën. Po ashtu, u pajtuan që FFK-ja dhe komuna të ndërhyjnë edhe në riparimin e fushës stërvitore në Shkugëz, e cila është ndërtuar vite më parë nga federata, por ka pësuar degradim si pasojë e moskujdesjes së duhur. Bashkërisht me komunën do të riparohet dhe organizohet kjo fushë në mënyrën më të mirë që të jetë në gjendje optimale për klubet. Ndërkaq, fusha e re do të jetë nën menaxhimin e LRF Gjakovës dhe do të shërbejë për të gjitha shkollat e futbollit që nuk zotërojnë fushat e tyre.

Cavalli: Prishtina është emër i madh edhe në Evropë, dua ta fitoj titullin



PRISHTINË, 24 KORRIK - Trajneri i Prishtinës, Jean-Michel Cavalli, ka thënë në një intervistë për faqen zyrtare të klubit se ai dëshiron ta fitojë titullin kampion në Superligën e Kosovës dhe ky është objektivi i ekipit. Prishtina këtë sezon do ta nisë me ndryshime të mëdha në ekip, por edhe në stafin teknik, pasi ka ndryshuar trajner. Francezi Jean-Michel Cavalli e ka pasuar Emmanuel Egbon e larguar pas përfundimit të sezonit 2024/25 dhe francezi është i gatshëm për aventurën me kryeqytetasit. Cavalli ka thënë se e ka njohur Prishtinën para se të bëhet trajner, ndërsa

objektivi i qartë është titulli kampion këtë sezon. “Prishtina është emër i madh edhe në Evropë. Para se të vija unë kisha informata për Prishtinën. Ka një president shumë të mirë dhe shtabi teknik dhe drejtori sportiv janë njerëz të mrekullueshëm. Për mua është e rëndësishme që ata e kuptojnë futbollin dhe kjo me pëlqen”, ka thënë fillimisht Cavalli. “Stafi i trajnerëve vendas janë një zemër e madhe e klubit dhe kjo është shumë e rëndësishme, klubi është si një familje. Tash është e rëndësishme t'i fitojmë ndeshjet sepse si lojtarët, tifozët, trajneri e drejtuesit janë

të lumtur kur ekipi fiton”. “Aktualisht jemi të përgatitur 70 %, kemi dy lojtarë që nuk kanë marrë vizë dhe nuk kanë arritur të ushtrorjnë dhe këta dy lojtarë janë të rëndësishëm për ekipin e Prishtinës. Kam ardhur këtu me objektiv të qartë. Dua ta fitoj titullin. Kam pasur një karrierë të suksesshme në shumë vende dhe dëshira ime është të fitoj edhe këtu”, ka deklaruar ai. “Mesazhi im për ‘Plisat’ është se jam i sigurt që do ta ngrehim Prishtinën lart dhe jam i bindur që ekipi është i gatshëm dhe besoj se do të arrijmë ta fitojmë titullin”, ka përfunduar trajneri francez.

Kosova mëson orarin për EuroBasket

PRISHTINË, 24 KORRIK - Kanë mbetur më pak se dy ditë për fillimin e EuroBasketit për grupmoshën U18, i cili do të mbahet në Shkup të Maqedonisë së Veriut. Në këtë turnament do të marrë pjesë edhe Kosova. Vendi ynë do të ketë punë me

kombëtare si Estonia, Hungaria, Zvicra, Islanda e Polonia. Tashmë është publikuar orari i dardanëve. Djelmoshat e ri do ta nisin aventurën më 26 korrik ndaj Estonisë, pastaj do të përballen me Hungarinë, Zvicrën,

Islandën e Poloninë. Të gjitha këto ndeshje Kosova do t'i luajë për një afat gjashtëditor. Eurobasketi për Divizionin B për U18 që do të mbahet në Shkup të Maqedonisë së Veriut do të nisë nga 26 korriku deri më 4 gusht.

ORARI	
26 korrik	
13:30	Estonia-Kosova
27 korrik	
16:00	Hungaria-Kosova
28 korrik	
18:30	Zvicra-Kosova
30 korrik	
13:30	Islanda-Kosova
31 korrik	
15:00	Kosova-Polonia



Daja: Do të luftojmë për kualifikim, shanset janë 50-50

Suharekë, 24 korrik - Klubi i Ballkanit po shfaq në këtë sezon në Evropë një formë krejtësisht ndryshe nga ajo e viteve të mëparshme ku siguroi fazën në grupe të Ligës së Konferencës. Kampionët e Kosovës nuk ia kanë dalë të

fitojnë as ndeshjen e radhës në shtëpi përballë Hamrunit të Maltës duke vënë në dyshim kualifikimin. Pas përfundimit të ndeshjes, trajneri Ilir Daja për "RTK" ka deklaruar: "Një ekip që është kompozuar, në muajt e fundit janë larguar 7

lojtarë, nëse e shikojmë që një vit, është larguar një formacion i tërë. Sot kishim shanset për të shënuar, kishim një penallti të humbur, kundërshtari nuk na rrezikoi asnjëherë". "Kemi ndryshime nga ndeshja me Santa Coloman, e kemi

kontrolluar gjithë lojën, niveli i ekipit maltez ishte më i lartë se ai nga Andorra. Do të luftojmë për këtë kualifikim. Kemi shanset 50-50. Do të tentojmë edhe në ndeshjen e dytë një rezultat që na kualifikon", ka shtuar Daja.



Sa vlejné medaljet Olimpikë në Paris?

PARIS, 24 KORRIK - Lojërat Olimpikë në Paris janë pranë (26 korrik - 11 gusht 2024) dhe me këtë rast organizatorët kanë përgatitur saktësisht 5084 medalje që do t'u shpërndahen sportistëve më të mirë në botë. Por, sa vlejné financiarisht ato? Për çdo sportist, një medalje olimpikë nuk ka çmim. Ato janë të shtrenjta edhe për koleksionistët, por vlera e tyre në fushën teknike nuk është aq e madhe. "Gazzetta dello Sport" ka zbuluar tashmë se sa vlejné teknikisht medaljet olimpikë, nëse metalet do të shkriheshin. Organizatorët e Lojërave Olimpikë në Paris bënë 5 084 kopje të medaljeve të arta, argjendta dhe bronzta që presin pronarët e tyre të rinj. Ajo që i ndan olimpistët e këtij viti nga e kaluara është fakti se në çdo medalje do të futet një copë hekuri nga Kulla Eifel. Në çdo medalje do të përdoren 18 gram hekur nga Kulla Eifel dhe pjesët që janë përdorur gjatë restaurimeve të mëparshme do të përdoren, pra nuk do të hiqen nga ndërtesa aktuale. Medalja e artë peshon 529 gramë, argjendi



525 gramë dhe bronzi 455 gramë. Sa iu përket medaljeve të arta, natyrisht, ato nuk janë plotësisht të arta. Vetëm në Lojërat Olimpikë në vitet 1904, 1908 dhe 1912 medaljet u bënë tërësisht prej ari të pastër. Pas kësaj, Komiteti Olimpik Ndërkombëtar vendosi një normë që thotë se gjashtë gram ari të pastër shkojnë në medaljen e artë në Lojërat Olimpikë. 523 gramët e mbetura të përdorura për medaljen e artë janë prej argjendi me një pastërti minimale prej 92.5-përqindësh. Nëse do të shisje një medalje ari

nga Parisi, thjesht duke shkrië metalin, do të merrje "vetëm" 700 euro. Me të njëjtin parim po t'i shkrije metalet nga medalja e argjenditë, do të merrje 400 euro. Gjëja më interesante është se vlera e medaljes së bronzitë është shtatë euro. Është e qartë se aliazhi i përbërë nga bakri dhe zinku ka një vlerë të papërfillshme në treg në krahasim me arin dhe argjendin, por miliona sportistë do të jepnin gjithçka për të marrë në dorë atë medalje, e cila fizikisht vlen shtatë euro.

Pedro Sequeira çmon sekretarin e përgjithshëm Gjinovci dhe gjithë stafin e Evropianit

PRISHTINË, 24 KORRIK - Anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Federatës Evropiane të Hendbollit, Pedro Sequeira, përmes dy postimeve ka treguar simpatinë e madhe për Federatën e Hendbollit të Kosovës dhe për Kosovën në përgjithësi. Portugezi Sequeira ishte përfaqësuesi më i lartë dhe kryesor i EHF-së në Evropianin U20 në Prishtinë. Ai ka publikuar një postim emocionues për sekretarin e përgjithshëm të Federatës së Hendbollit të Kosovës, Izet Gjinovci, që po e kalon një sfidë shëndetësore. Sequeira dhe Gjinovci kanë ndarë së bashku trofetë për lojtarët më të mirë të Evropianit. "Gjithnjë në mendjen time dhe zemrën time, Izet. Unë e di që do të luftosh. Kosovës dhe hendbollit në gjithë botën i duhesh", ka shkruar Sequeira. Në një postim tjetër ai ka vlerësuar lart stafin organizativ të Evropianit U20. "Komplet ekipi që



punoi me mua gjatë 11 ditëve në Kosovë. Ishin të përkushtuar thajse 24 orë në ditë për hendbollin dhe të gjithë ishin fantastikë. Asnjëri asnjëherë nuk është dukur i lodhur dhe nuk kishte ankese. Fokus i plotë. Kjo e bëri shumë të lehtë për të

punuar dhe për të menaxhuar të gjithën. Faleminderit ekipit", ka shkruar Sequeira. Federata e Hendbollit e Kosovës e vlerëson qëndrimin dhe përkrahjen e Sequeiras, mikut të madh të Kosovës.

SHKURT

KB Vëllaznimi përforcohet me Arbin Rushiti

KB Vëllaznimi ka nënshkruar me basketbollistin 23-vjeçar Arbin Rushiti, i cili nga viti 2022 e deri në vitin 2024 ka qenë pjesë e skuadrës së Çairit në Maqedoninë e Veriut. Rushiti është i gjatë 185 cm dhe luan në pozitën e organizatorit. Sa iu përket transferimeve të reja, "Telegrafi" raporton se qëllimi kryesor i KB Vëllaznimi është që fillimisht klubi të arrijë marrëveshje me basketbollistët vendorë, që më pas, në bashkëpunim me trajnerin Pavić, t'i shohin edhe opsionet e nevojshme që duhen plotësuar me basketbollistë të huaj, për të qenë sa më të gatshëm për fillimin e sezonit 2024/2025 të Superligës së basketbollit kosovar. Edicioni i ri i Superligës së Kosovës në basketboll pritet të fillojë më 14 shtator.

Milani fillon kontaktet me Brojën

AC Milan është duke e kërkuar një tjetër sulmues në afatin veror pas transferimit të Alvaro Moratas nga Atletico Madridi. Dhe siç raporton "Calciomercato", skuadra italiane tashmë ka nisur kontakte të reja me sulmuesin e Kombëtares së Shqipërisë, Armando Brojën. Broja momentalisht gjendet në "tour" me Chelsean në Amerikë – ku Enzo Maresca e ka marrë me vete për testin e fundit. Milani kërkon Brojën vetëm në formë huazimi, pasi që dështoi transferimi i sulmuesit gjerman Niclas Fullkrug. Broja është duke pasur shumë oferta në tavolinë, përfshirë këtu edhe skuadrat nga Premierë Ligës si Southamptoni dhe Evertoni.

Guardiola e dëshiron Donnarumman te City

Manchester City është në kërkim të një trajneri dhe Pep Guardiola ia ka "vënë syrin" gardianit të PSG-së, Gianluigi Donnarumma. Kërkesat e shumta për Ederson nga Arabia Saudite dhe shuma prej 50 milionë eurosh e ofruar, ka bërë që City të kërkojë portier të ri pasi kërkon ta shesë brazilianin. Është "Daily Express" në Britani që bën me dije se Guardiola ka besim tek aftësitë e italianit Donnarumma dhe e kërkon në ekip. Gigio prej 2021-s është pjesë e PSG-së dhe ka kontratë deri në verën e 2026, teksa francezët nuk e lëshojnë lirë. Afro 60 milionë euro kërkon PSG për ta lënë të lirë portierin, që nga ana e tij nuk do të kërkonte një lëvizje për një pagë sezonale më pak se 12 milionë euro, aq sa paguhet në Paris. Sigurisht që shekët nga Arabia nuk i tremb kjo shifër që, mbi të gjitha, kërkojnë ta "blindojnë" katërkëndëshin dhe ta kënaqin Guardiolen.

Endrick: Jam i dashuruar me Realin

Endrick është i çmendur pas Madridit dhe Realit, edhe para se ta nisë aventurën e tij të re. Talenti i njohur, i cili do të prezantohet nga "Los Blancos" të shtunën e 27 korrikut, foli për përvojën që do të fillojë te kampionët e Evropës. "Më pëlqen gjithçka në Madrid. Unë kam qenë tashmë në këtë qytet. Tani kam një shtëpi këtu. Njerëzit në Madrid janë shumë të mirë. Kam kaluar shumë me shokët e mi të Real Madridit. Ata më folën në mënyrë perfekte për këtë vend", ka deklaruar Endrick.

Sportisti polak pezullohet përkohësisht për doping para Lojërave Olimpikë

Kërçyesi polak Norbert Kobielski është suspenduar përkohësisht për doping vetëm disa ditë përpara Olimpiadës së Parisit, njoftoi të martën Njësia e Integritetit

të Atletikës (AIU). Kobielski, i cili rekordin më të mirë personal e ka prej 2.33 metrash, përfundoi i 10-ti në kampionatin botëror të vitit të kaluar në Budapest dhe i

gjashti në kampionatin evropian në Romë muajin e kaluar. Kobielski është larguar nga delegacioni olimpik polak në kryeqytetin francez. AIU tha se ai kishte

rezultuar pozitiv për "metabolitin e ndaluar pentedrone norephedrine". Ceremonia e hapjes për Lojërat Olimpikë 2024 zhvillohet të premten

përgjatë lumit Seine, megjithëse kualifikimet e kërcimit së larti për meshkuj nuk do të zhvillohen deri më 7 gusht, me finalen tri ditë më vonë.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime
drejtë përqaditjes së;

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gieipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “F&F Business Services” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b UNIK: 812007418 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

ORAVESTEN.JE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "F&F Business Services" D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812007418 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "F&F Business Services" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812007418 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Nazim Vezgishi shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Agron Karaabo shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q, K. "11 Marsi" Prizren.

- Omer Yarimhiroz shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Gentrit Kryezi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX SHFMU "Dy Dëshmorët" Piranë.

- Kleopatra Nimani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; 10,11,12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”. Gjakovë.

- Fiqirije Elezaj nga Damjani i Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën plotësuese të SH.F.M.U "Hamëz Cena", Damjan.

- Art Zeka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; 10,11,12 si dhe certifikatën e maturës dhe diplomën e shkollës “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-2275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139


- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallone me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjen-
det prapa AAK-së me kushte të volit-
shme dhe po ashtu me çmim të
volitshëm. Për informata më të hol-
lëshishme na kontaktoni në numrin e
tel: viber +37744162783 dhe
049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

